

BARDHYL DEMIRAJ

**PROF. E. ÇABEJ PËR MARRËDHËNIET GJUHËSORE TË SHQIPES
ME RUMANISHTEN**

Shqyrtimi i marrëdhënieve të shumanshme që gjuha shqipe ka vendlodur me rumanishten gjatë historisë së saj ballkanike zë një vend të rëndësishëm në veprimtarinë shkencore të prof. E. Çabejt. Gjatë trajtimit të tyre si një objekt i veçantë, ai zbuloi në to dhe njëren nga rrugët e sigurta metodologjike për shtjellimin e një vargu qështjesh që lidhen me etnogjenezën e popullit shqiptar, me historinë e gjuhës dhe të kulturës së tij shumëshekullorë.

Prof. E. Çabej debutoi në këtë fushë studimi në një periudhë kur shkenca e balkanologjisë dhe ajo e albanologjisë nuk kishin kristalizuar ende një metodë të përshtatshme në shtjellimin e materialit gjuhësor faktik, që mblidhej prej më se dy shekujsh, kur vazhdonin të mbijetonin gjykime të errta logjiciste rrith natyrës së këtyre marrëdhënieve, rrith mjedisit gjeografik dhe kushteve historiko-sociale të përfitimit të tyre. Duke qenë të mpleksura fort me errësirën thuajse të plotë të të dhënave dokumentare për pjesën jogreke të Ballkanit antik e të mesjetës së hershme, këto bashkëpërkime gjuhësore dhe jo vetëm gjuhësore kishin lënë shkas për interpretimet gjithfarëshe, në të cilat djepi i formimit të etnosit shqiptar shtegtonte, sipas rastit, drejt veri-lindjes: në trekëndëshin gjeografik Nish-Sofje-Shkup; në malet Ballkan; ngjitej në veri të lumit Danub deri në masivin e maleve Karpatë ose zbriste më në jug-perëndim: në Panoni, në bregdetin dalmat e gjetkë. Së bashku me të edhe gjuha shqipe vendoste lidhje gjenetike të pandërmjetme herë më ilirishten e herë me gjuhë ose dialekte të tjera të Ballkanit antik, si trakishtja, dako-myziqhtja, panonishtja etj.

Merita kryesore e prof. E. Çabejt është se diti të orientohet drejt në këtë amalgamë pikëpamjesh, duke i siguruar që në fillim një vend nderi shkencës së re shqiptare.

Nëpërmjet njoftes së thelluar dhe shkencore të të dy gjuhëve, prof. E. Çabej rimerr në shqyrtim gjithë materialin gjuhësor faktik të sjellë gjer atëherë, e shoshit dhe e pasuron atë më tej, duke bërë një organizim të ri sistemor. Veçon si më të rëndësishme ato bashkëpërkime që janë karakteristike vetëm për këto dy gjuhë, i grupon ato sipas nënsistemeve gjuhësore: fonetikë, morfologji, sintaksë, fjalëformim, leksik e frazeologji dhe ia nënshttron një analize të thelluar diakronike, të mbështetur në një metodologji të re shkencore.

Zhvillimi që morën studimet historike në gjuhësinë shqiptare të kësaj periudhe u karakterizuan, nga njëra anë, me përpjekjet për ndricimin e çështjeve të ndryshme në planin e brendshëm të qëdo gjuhe, dhe, nga ana tjetër, me përcaktimin më të qartë të disa kritereve shkencore që duhej t'u përbaheshin studimet në planin krahasues të jashtëm.

Duke shqyrtuar dukuritë e përbashkëta në planin e brendshëm të secilës gjuhë, prof. E. Çabej erdhi në përfundimin se ato nuk shpjegohej të gjitha me një gurrë të vetme gjuhësore.

Kështu për një numër dukurish, kryesisht të karakterit fonologjik, morfologjik e sintaksor, ai pranon zhvillimin e pavarur të sistemit të secilës gjuhë, prirjet e përbashkëta të zhvillimit që kanë përfshirë familjen i.e. në përgjithësi, dhe këto dy gjuhë në veçanti. Gjatë shqyrtimit të mëtejshëm të këtyre dukurive prof. E. Çabej konstaton se shtresimi kronologjik i çdonjërës prej tyre nuk është i njëjtë. Një pjesë paraqitej si trashëgimi i.e. e gjuhës, ndërsa një pjesë tjetër ishte përfuar në periudha të ndryshme të evolucionit të mëvetësishëm të secilës gjuhë. Këto vëzhgime shërbyen si pikënisje për studimet krahasuese të mëtejshme në gjuhësinë historike shqiptare në përgjithësi. Në këto përfundime u arrit p.sh. gjatë shqyrtimit të sistemit gramatikor, ku përfshihen ndër të tjera: analitizmi në sistemin foljor, si rezultat i prijes për një qartësim sa më të madh të kumtimit; prapavendosja e nyjës shquese dhe lindja e nyjës së përparme me disa funksione; në sistemin fonetik kemi: kushtet e përfitimit të zanores së reduktuar /ë/ : rum. /ă/; dukuritë dialektore të nazalizmit e të rotacizmit, diftongimi i zanores */e/ > shq. /ia/; rum. /iea/ etj.

Nga ana tjetër, në qerthullin e dukurive të përbashkëta prof. E. Çabej veçon edhe një numër bashkëpërkimesh, kryesisht të fushës së leksikut, struktura fonologjike e të cilave gjente shpjegim vetëm nëpërmjet shqipes. Kurse në rumanishte ato mbeteshin të izoluara. Të tilla janë p.sh. njësi të ndryshme leksikore si shq. *moshë* — rum. *moş* «i moshuar, plak»; *hamës* — rum. *hameş*; shq. *gérresé* — rum. *gresie*; shq. *vatér* — rum. *vatră*; shk. *karpé* — rum. *Carpați*; shq. *máz/méz* — rum. *mâinz* e shumë njësi të tjera leksikore e frazeologjike që janë vënë në qendër të studimeve të tij etimologjike.

Arrijet e dukshme të studimit të thelluar në planin e brendshëm të secilës gjuhë ndihmuani mjaft hulumtimet në planin krahasues të jashtëm, të cilin prof. E. Çabej ua nénshtron disa kritereve shkencore më të qarta, siç janë p.sh. kronologjia e lindjes dhe e ndalimit të dukurive të përbashkëta në përqasjen midis gjuhëve, marrja në vështrim kryesisht e bashkëpërkimeve specifike për këto dy gjuhë, shkalla e shtrirjes së tyre dialektore etj.

Shqyrtimi i përbashkësive gjuhësore shqiptare-rumune mbi bazën e këtyre kritereve shtroi përpala gjuhësë shqiptare edhe kërkesën për të vendosur një raport të drejtë ndaj vendit të faktorëve brenda dhe jashtëgjuhësorë që i kanë kushtëzuar këto marrëdhënie. Prof. E. Çabej, i mbështetur fort në faktorët brendagjuhësorë, nuk la jashtë vështrimit edhe faktorët jashtëgjuhësorë, duke dalluar qartë edhe fushat ku këta faktorë kanë vepruar më dukshëm. Kështu, ndërsa në studimin e dukurive të ndryshme të sistemit fonetik dhe gramatikor do të synohet kryesisht në shqyrtimin e sistemit të secilës gjuhë, në studimet në fushën e

leksikut, frazeologjisë e deri diku edhe në ato të sintaksës do t'u kushtohet rëndësi edhe faktorëve jashtëgjuhësorë.

Thellimi i studimeve mbi bazën e kritereve dhe të drejtimeve të sipërtreguara, bashkërendimi i tyre, duke i dhënë përparësi studimit të çdo dukurie në planin gjuhësor të brendshëm, bënë që prof. E. Çabej të mënjanonte të gjitha tezat e mëparshme që invokonin një lidhje gjene-tike të drejtpërdrejtë të të dy gjuhëve me të ashtuquajturin «substrat» të përbashkët e bashkë me të edhe të ashtuquajturën bijësi të shqipes nga trakishtja, dialekti trako-dak, dako-mis, apo nga dialekti i besëve. Me anën e këtyre studimeve si edhe me ndihmesat e rëndësishme në fushën e toponomastikës historike të Ballkanit ai hedh poshtë edhe ato mendime që e çonin djepin e formimit të gjuhës shqipe e të popullit shqiptar deri në veri të lumi Danub.

Duke vërtetuar bindshëm autohtoninë e popullit shqiptar, në trojet e sotme, vijimësinë e pandërprerë të shqipes nga ilirishtja si edhe area-lin historik të shqipes që nuk paraqitet në kohën tonë si një «trevë ekspansioni, por restriksioni», prof. E. Çabej saktëson edhe natyrën e një pjese të bashkëpërkimeve specifike gjuhësore shqiptaro-rumune, kryesisht të fushës së leksikut e të frazeologjisë, si marrëdhënie të ndërsjella midis gjuhësh në kontakt. Gjithashtu ai përcakton edhe mjedisin hapsinor e kohor të këtyre marrëdhënieve që kanë prekur kryesisht fushën e leksikut, të frazeologjisë, e, më tej, edhe elemente të etnografisë dhe të folklorit të të dy popujve. Sipas tij — citojmë autorin — «Degët e skajit verilindor të etnosit shqiptar (Shar, Shkup, Nish etj.) në mesjetën e hershme, para dyndjes sllave, kanë qenë në fqinjësi të pandërmjetshme, fqinjësi kontakti me degët e skajit më jugperëndimor të etnosit rumun dhe kjo lidhje u ushqye më tej edhe me anën e transhumancës së barinjve shtegtarë. Ky kontakt që duhet të kenë qenë intim (deri në simbiozë), ka vazhduar gjatë (disa shekuj) deri në shek. X kur rumanishtja e përbashkët u nda në disa dialekta».

Sic del edhe nga këto mendime që u parashtruan këtu, prof. E. Çabej i vendos marrëdhëni gjuhësore midis shqipes dhe rumanishtes në një sfond historik gjuhësor më të gjerë se gjuhëtarët paraardhës. Përzgjedjen dhe hulumtimin e materialit faktik të organizuar sipas nënsistemeve të gjuhës ai e shpërndan në kuadrin e një triptiku: bashkëpërkime të trashëgura në të dyja gjuhët; bashkëpërkime të përfputara në mënyrë të pavarur në këto gjuhë; dhe bashkëpërkime si rezultat i ndikimit të ndërsjellë midis tyre. Këtu qëndron edhe origjinaliteti dhe ndihmesa e vyer e prof. E. Çabejt në studimin e marrëdhënieve gjuhësore shqiptare-rumune, e cila ka hyrë tashmë në visarin e shkencës dhe të kulturës shqiptare, si edhe të shkencës së balkanologjisë në përgjithësi.

Por kontributi i prof. E. Çabejt nuk mund të rrudhet vetëm në përcaktimin e natyrës së këtyre marrëdhënieve dhe të kushteve social-historike të përfftimit të tyre. Hulumtimi në këtë fushë studimi do ta

ndihmojë dijetarin e shquar në veprimtarinë e mëtejshme shkencore, përtë krijuar një vizion tërësor mbi rolin që ka luajtur gjuha shqipe në ngjizjen e lidhjes gjuhësore ballkanike, si njëra nga bazat themelvënëse të saj, mbi forcën e madhe rrezatuese të kulturës shqiptare gjatë shekujve.

Nga ana tjetër, rezultatet e arritura në këtë fushë studimi, prof. E. Çabej do t'i shfrytëzojë gjerësisht edhe në studimet e mirëfillta dia-kronike mbi gjuhën shqipe. Me një akribi shkencore ai qëmton shumë elemente të shqipes, që kanë kaluar, në rrjedhë të kohës, në gjuhët fqinje, duke përfshirë këtu edhe rumanishten, dhe që në këto gjuhë kanë ruajtur forma arkake, ndërsa në vetë shqipen paraqiten me formë të evoluar. Këto gjurmë i shërbejnë prof. E. Çabejt si një mjet ndihmës i nevojshëm përtë shtjelluar disa tipare të lashta të sistemit fonetik, morfoligjik e leksikor të shqipes, të cilat, përses që diken, hasin vështirësi përtu kontrolluar në planin gjuhësor të brendshëm.

Kështu, prof. E. Çabej vërteton, ndër të tjera edhe së jashtmi, se ndarja dialektore e shqipes është e një moshe relativisht të re, që nuk i ka përfshirë kontaktet e ndërsjella midis dy gjuhëve. Porse, në periudhën e këtyre kontaktave kishte filluar ngulitja e theksit në rrokin parafundore: shq. *këlbaزé*, ~ rum. *gălbează*; ishte përfthuar shndërrimi fonologjik /gl/ > /g/ shqip *gjëmb* ~ rum. *ghimpe*; ekzistonë një shkallë e përbashkët e gjuhës: *zanore gojore + n*, e cila u paraprin dukurive të nazalizmit dhe të rotacizmit: shq. *kërcun* (*kërcur-i*) ~ rum. *crăciun*; *kur-për* (*kułpér*) ~ rum. *curpen* etj.

Sic del edhe nga kjo paraqitje tepër e përmbledhur, vepra e prof. E. Çabejt në fushën e marrëdhënieve që ka vendosur shqipja në rrëthim e gjuhëve fqinje, duke përfshirë këtu edhe rumanishten, ka hyrë tashmë në trashëgiminë e shkencës dhe të kulturës shqiptare. Ajo do të shërbejë kurdoherë si udhërrëfyese në studimet e mëtejshme shkencore.

BIBLIOGRAFI

1. *Problemi i autoktonisë së shqiptarëvet në dritën e emrave të vëndeve*, BUSHT, SSHSH, 2, 1958, f. 54-62.
2. Rum. Crăciun «kérshëndella» në SCL, XII, 3, 1961, f. 313-317.
3. *Disa fazë të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinjë*, në «Revistë shkençore e Institutit Pedagogjik Dydjeciar Shkodër», 1, 1964, f. 5-27.
4. *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe*, në «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», Tiranë, 1965, f. 89-108.
5. *Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, SF, 4, 1970, f. 3-15.
6. *Nga historia e gjuhës shqipe, probleme dhe rezultate*, «Zëri i popullit», 23 janar, 1972, nr. 29.
7. *Shqipja dhe gjuhët fqinjë*, SF, 4, 1973, f. 95-105.
8. *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, SF, 2, 1974, f. 14-51.
9. *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare*, SF, 1, 1975, f. 49-62.

Zusammenfassung

**Egerem Çabejs Beitrag zu den albano —rumänischen
Sprachbeziehungen**

In diesem Vortrag handelt es sich um den bedeutenden Çabejs Beitrag zur Untersuchung der sprachlichen Beziehungen, welche das Albanische im Verlaufe seiner balkanischen Geschichte mit dem Rumänischen, sowie mit den übrigen Balkansprachen eng angeknüpft haben. Seine verdienstvolle Leistung auf diesem Gebiet besteht darin, dass er das dazugehörige, den Sprachuntersystemen nach eingeordnete Sprachmaterial auf dem Rahmen eines folgendem Triptyks ausgeteilt hat: Übereinstimmungen, die von beider Sprachen altererbt sind; Übereinstimmungen, welche sich beide Sprachen unabhängig voneinander entwickelt haben; Übereinstimmungen, die als Ergänziss des gegenseitigen Einflusses entstanden sind.